



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. Rregj. Them. 5695/1262
Dt. Regj. 02.07.2014

Nr. Vendimi 2015
Dt. Vendimi 30.09.2015

V E N D I M
“Ne emër te Republikës”

Gjykata Administrative e Apelit me trup gjykues te përbërë prej:

Kryesuese: Rilinda SELIMI
Anëtare: Alkelina GAZIDEDJA
Anëtare: Blerona HASA

me sekretare gjyqësore **Afede RUNAJ**, në Tiranë, sot më datë 30.09.2015 mori ne shqyrtim ne dhomë këshillimi çështjen administrative nr. 5695/1262 akti, dt. Regjistrimi 02.07.2014 që u përket palëve ndërgjyqëse:

PADITËS: Nasi Pipa, i biri i Petro dhe Sena, i datëlindjes 19.05.1963, lindur në Marinëz dhe banues në Fier, Lagja “Kastriot”

I PADITUR: Drejtoria Rajonale Tatimore Fier

OBJEKTI: Detyrimin e palës së paditur të nxjerrë dhe miratojë aktin administrativ të faljes dhe të shuarjes së detyrimit tatimor evidentuar në akt njoftim vlerësimin nr. 677 prot. datë 12.01.2011 të lindur në periudhën dhjetor 2012 me procesverbalin nr.0033371 datë 15.12.2010 dhe të kontabilizuar për periudhën tatimore dhjetor 2010 si dënim pa tatim si dhe detyrimin e palës së paditur që të kryejë pasqyrimin e këtij fakti dhe fshirjen e këtij detyrimi tatimor nga regjistrat kontabël të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier.

Pezullimin e zbatimit të cdo akti apo veprimi të administratës tatimore për mbledhjen e këtij detyrimi tatimor, deri sa vendimi gjyqësor të marrë formë të prerë, konkretisht pezullimin e zbatimit të aktit administrativ njoftim vlerësimin nr. 677 prot. datë 12.01.2011 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier si dhe cdo akt tjetër të dalë në bazë dhe për zbatim të tij për mbledhjen dhe rikuperimin e këtij detyrimi.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 32, 153 e vijues, nenet 324-333 të K.Pr.Civile, Nenet 44 e vijues te K.Pr.Administrative, neni 18, 19, 28, 33, 35 dhe 36 të Ligjit nr. 10148 datë 21.04.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”, Akti Normativ Nr. 5, datë 28.12.2011 “Për një ndryshim në ligjin Nr. 10418, datë

21.04.2011 "Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor" si dhe Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 12 datë 18.05.2011 "Për procedurat e zbatimit të ligjit Nr. 10418, datë 21.04.2011" i ndryshuar.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin Nr.62-2012-3680 (1005), datë 21.05.2012 ka vendosur:

- *Rrëzimin e padisë.*
- *Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse.*

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë, paditësi Nasi Pipa, duke paraqitur të njëjtat shkaqe si ato të paraqitura në parashtrime dhe konkretisht:

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier duke vendosur rrëzimin e padisë së paraqitur prej meje nuk ka bërë gjë tjetër përveç se ka lënë në fuqi një urdhër të padrejtë, arbitrar dhe të paligjshëm.
- Bazuar në nenin 19 shkronja "a" të ligjit Nr. 10418, datë 21.04.2011 "Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor" si dhe Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 12 datë 18.05.2011 "Për procedurat e zbatimit të ligjit Nr. 10418, datë 21.04.2011" i ndryshuar pika 3 shkronja "a" kërkoj të më falet dhe të shuhet nga regjistrat e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier gjoba prej 100 000 lekë që i përket periudhës dhjetor 2010 dhe është vendosur nga organi tatimor sipas procesverbalit Nr. 0033371, datë 15.12.2010, dhe e kontabilizuar për periudhën dhjetor 2010 pasi bazuar në sa më sipër ligji dhe udhëzimi ka përcaktuar qartë që kushti i vetëm për aplikimin dhe përfitimin nga ligji i faljes së gjobave është periudha tatimore dhe në rastin konkret periudha tatimore së cilës i përket gjoba është dhjetor 2010.
- Bazuar në nenin 442 e vijues dhe 466/b duke konsideruar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier një vendim të padrejtë, të pabazuar në ligj, në faktet dhe në provat e administruara, duke menduar se kërkesë padia e paraqitur prej meje është e bazuar në ligj dhe duhet të pranohet, kërkoj ndryshimin e vendimit Nr.62-2012-3680 (1005), datë 21.05.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, duke vendosur pranimin e kërkesë padisë sipas objektit të saj.

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin Nr. 652 datë 15.04.2014 ka vendosur:

"Shpalljen e moskompetencës së Gjykatës së Apelit Vlorë për gjykimin e çështjes civile me Nr. 1807, datë 27.06.2012 dhe dërgimin e akteve për kompetencë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë".

Gjykata Administrative e Apelit;

Si u njoh me relatimin e **gjyqtares Rilinda Selimi**, shqyrtoi aktet e dosjes dhe analizoi çështjen në tërësi;

V Ë R E N

Se ankimi i paraqitur nga paditësi nuk përmban shkaqe ligjore dhe faktike për cenimin e vendimmarrjes së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për rrëzimin e padisë dhe për pasojë vendimi objekt ankimi nr. (3680) 1005, datë 21.05.2012 duhet lënë në fuqi.

Nga materialet e ceshtjes pranohet e provuar se paditësi Nasi Pipa është i regjistruar si person fizik pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, me NIPT K6282401R, me objekt aktiviteti shitje produkte pastiçerie.

Me njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore, të nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, Nr. 677 Prot. datë 2.01.2011, për periudhën deri në datën 06.01.2011 rezulton se paditësi ka pa paguar 100.000 lekë dënim pa tatim. Rezulton se ky detyrim është gjobë vendosur ndaj paditësit për moslëshim të kuponit tatimor në bazë të procesverbalit të gjobës me Nr. 0033371 datë 15.12.2010.

Objekti i mosmarrëveshjes lidhet me refuzimin e kërkesës së paditësit drejtuar të paditurit Drejtoria Rajonale Tatimore Fier për faljen e këtij detyrimi sipas ligjit Nr. 10418, datë 21.04.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”.

Paditësi i ka parashtruar palës së paditur se ka gjetur emrin e tij në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në listën e subjekteve që përfitojnë nga ligji i faljes, njëkohësisht pretendon se është njoftuar nga pala e paditur që është përfitues nga ligji i faljes.

Në datë 13.03.2012 paditësi i është drejtuar me kërkesë Avokatit të Tatimpaguesve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, duke kërkuar ndërhyrjen e tij për faljen e gjobës.

Pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Fier me shkresën nr. 4535/1 datë 29.03.2012 bën me dije paditësin si dhe Avokatin e Tatimpaguesve se në lidhje me këtë penalitet paditësi është njoftuar më datë 12.01.2011, me njoftim vlerësimi tatimor Nr. 677 Prot., dhe në këtë situatë nuk është objekt i zbatimit të nenit 21 të ligjit. Duke qenë se subjekti Nasi Pipa nuk është evidentuar në sistemin informatik brenda datës 31.12.2010 atëhere nuk përfiton nga ligji i faljes në zbatim të nenit 19/a të ligjit Nr. 10418, datë 21.04.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor” si dhe Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 12 datë 18.05.2011 “Për procedurat e zbatimit të ligjit Nr. 10418, datë 21.04.2011” i ndryshuar, pika 3/a.

Në këto kushte, pala paditëse e ka bërë cështjen objekt konflikti gjyqësor me padinë objekt gjykimi duke kërkuar pranimin e saj me pretendimin se gjoba prej 100 000 lekë i përket periudhës dhjetor 2010 pasi është vendosur nga organi tatimor sipas procesverbalit Nr. 0033371, datë 15.12.2010. Ky penalitet është kontabilizuar për periudhën dhjetor 2010 dhe në këto kushte përfshihet në veprimin e ligjit. Ligji dhe udhëzimi ka përcaktuar qartë që kushti i vetëm për aplikimin dhe përfitimin nga ligji i faljes së gjobave është periudha tatimore dhe në rastin konkret periudha tatimore së cilës i përket gjoba është dhjetor 2010.

Keto pretendime parashtrohen edhe ne ankim, kunder vendimit (3680) 1005, datë 21.05.2012 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Fier per rrezimin e padise. Gjykata e Apelit Vlorë nuk shqyrtoi ne shkalle te dyte ceshtjen, ne kushtet e percaktimeve te reja ligjore sipas Ligjit nr. 49/2012 per funksionimin e gjykatave administrative me dt. 04.11.2013, me vendimin Nr. 652 datë 15.04.2014 ka derguar per kompetence shqyrtimin e kesaj mosmarreveshje administrative Gjykates Administrative te Apelit.

Kolegji Administrativ i Apelit, ne konstatim te faktit se ankimi plotëson kushtet ligjore te pranueshmerise per shqyrtim, cmon se shkaqet e ngritura edhe ne ankim nga paditesi me te drejte jane cilesuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Fier pa mbeshtetje ligjore e per pasoje vendimi Nr. (3680) 1005, datë 21.05.2012 per rrezimin e padise duhet lene ne fuqi.

Ne te kundert sa pretendohet edhe ne ankim Kolegji cmon se gjykata e shkalles se pare ka zgjidhur ceshtjen ne perputhje me ligjin dhe provat duke u bere fakteve nje cilesim te drejte e ligjor.

Sipas paditësit parashtrohet dhe në ankim se kërkimi i tij për faljen e detyrimit, gjobë në masën 100.000 leke gjen mbështetje në ligjin nr. 10418, datë 21.4.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”.

Rezultoi se ky detyrim i është njoftuar paditësit përmes njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, Nr. 677 Prot. datë 12.01.2011 në zbatim te Nenit 122/1,b,i te Ligjit Nr.9920 Dt.19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise”, ku parashikohet se:

Tatimpaguesi, person juridik, denohet me gjobe...nese...:

“b) nuk lëshon kupon tatimor për qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve, për çdo rast konstatimi:

i) për kontrollin e parë, me gjobë, në masën 200 000 (dyqind mijë) lekë, për tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, dhe gjobë, në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë, për tatimpaguesit e tjerë”.

Kërkimi i paditësit është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit si dhe Udhëzimit Nr. 12, datë 18.5.2011 “Për procedurat e zbatimit të ligjit Nr. 10418, datë 21.4.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”.

Neni 19 i ligjit Nr. 10418, datë 21.4.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor” ka parashikuar:

Detyrimet tatimore që falen pa pagesë

Falen pa pagesa në favor të Buxhetit të Shtetit:

a) të gjitha detyrimet tatimore të personave fizikë, të regjistruara si subjekt i taksës vendore të biznesit të vogël, të mbetura të papaguara e që i përkasin periudhës tatimore deri më 31 dhjetor 2010;

b) të gjitha detyrimet tatimore të papaguara të individëve për periudhën tatimore deri më 31 dhjetor 2010.

c) detyrimet tatimore të papaguara të tatimpaguesve, persona juridikë apo persona fizikë, të regjistruar si subjekt i TVSH-së, që janë të evidentuar në regjistrat e administratave tatimore deri në datën 31 dhjetor 2008.

ç) të gjitha detyrimet e prapambetura të pronarëve të mjeteve për taksën e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve dhe taksën vjetore të qarkullimit rrugor për periudhën deri më 31 dhjetor 2010. Gjithashtu, falen detyrimet për këto taksa, për të gjitha mjetet e dala jashtë qarkullimit, por të paçregjistruara deri në datën 31 dhjetor 2010.

Ndërsa sipas Kreut II, pika “3” germa”a” të Udhëzimit Nr. 12 datë 18.5.2011 “Për procedurat e zbatimit të Ligjit Nr. 10418, datë 21.4.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor” rregullohet se “detyrimet tatimore të papaguara nga personat fizikë, subjekte të taksës vendore të biznesit të vogël, që i përkasin periudhës tatimore deri në 31.12.2010 dhe që janë të evidentuar në kontabilitetin tatimor/sistemin informatik, falen pa pagesë”.

Duke ju referuar Kreut 5.1 të Udhëzimit përcaktohet se:

5.1 Si datë e evidentimi në regjistrat tatimor do të konsiderohet:

a) Data e njoftim-vlerësimit tatimor në rastet kur detyrimi ka lindur nga një vlerësim nga zyra, verifikim në vend apo kontroll tatimor.

Në rastin konkret, data e evidentimit në regjistrat tatimorë të detyrimit tatimorë në shumën 100 000 lekë që paditësi ka ndaj Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, është data 12.01.2011 e njoftim-vlerësimit tatimor (sipas kreut 5.1 të udhëzimit Nr. 12, datë 18.5.2011). Për rrjedhojë detyrimi tatimor i paditësit në shumën 100 000 lekë nuk i përket periudhës tatimore deri më 31 dhjetor 2010 (sipas nenit 19 të ligjit Nr. 10418, datë 21.4.2011). Për këto arsye pretendimi i paditësit për fshirjen e këtij detyrimi tatimor nga regjistrat kontabël të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, me të drejtë është cilësuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier se nuk gjen mbështetje në nenin 19 të ligjit Nr. 10418 datë 21.4.2011 dhe në kreun 5.1 të Udhëzimit Nr. 12, datë 18.5.2011.

Ne përfundim të sa me sipër, Kolegji Administrativ i Apelit konkludon se Vendimi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier duhet të lihet në fuqi rrjedhojë e zbatimit të drejte të ligjit në faktet gjyqësore të ceshtjes. Pasur parasysh vlerën e detyrimit permbajtur në aktin administrativ objekt kundershtimi si dhe percaktimet e nenit 56 të Ligjit nr. 49/2012 ndaj këtij vendimi nuk lejohet rekurs.

PER KETO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, mbështetur në nenin 50, germa "b" të Ligjit nr. 49/2012 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative"

V E N D O S I

1. Lënien në fuqi të Vendimit Nr. (3680) 1005, datë 21.05.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.
2. Kundër këtij vendimi nuk lejohet rekurs.

U shpall në Tiranë, sot me 30.09.2015.

ANETARE
Alkelina GAZIDEDJA
DV
E NJESUAR ME ORIGJINALIN

ANETARE
Blerona HASA
DV

KRYESUESE
Rilinda SELIMI
DV

Kancelari
Leonard Steatay
Steatay